





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Data/Date:	19.09.2024
Nga/Od/From	Baki Beqiri
Për/Za/To:	Fadil Nura, kryetar i Komunës
CC	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i takimit për planifikimin e buxhetit – Klinë e Epërme

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me datë 13.08.2024 është hartuar dhe publikuar në web-faqen e komunës, orari i dëgjime dhe takimeve me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025, linku » [KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

Takimi në Klinë të Epërme

Takimi publik u hap më 21.08.2024, data 13:30 qytetarët u njoftuan nga drejtori i financave rreth qarkoreve bixhetore dhe kërkoi qqë të i japin mendimet dhe kërkesat e tyre të cilat do të inkoorporohen në buxhetin final.

Ljmi » [Kanë nisur sot dëgjimet buxhetore për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027. \(rks-gov.net\)](#)

Në Platformën e Konsultimeve Publike: » [KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 21.08.2024 mbahet konsultimi publik në Klinë të Epërme, në shkollën “Idriz Berani” Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Konsultimi publik filloi në orën 13; 30

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori për buxhet dhe financa z.Ismet Aliu me ç ‘ rast prezantoi buxhetin e mundshëm dhe qarçoret buxhetore si dhe kufijtë konform qarkores buxhetore përfundimtare

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Selim Bajraktari: A pritet të përfshihet në buxhet ndiçimi publik në Klinë dhe asfaltimi i disa rrugicave të shkurtëra	1.Po, ndiçimi publik dhe trajtimi i rrugicave dhe rirregullimi i disa pusetave të kanalizimit do të realizohet
Sami Tahiraj: Kur pritet të fillojë ndërtimi i subqendres dhe kemi nevojë për poligon	2. Subqendren do ta përfshijmë ne kete buxhet, ndërsa poligon jo, sepse e kemi ndërtuar ne lagjen Osaj
Ferit Bajraktari: A do te vazhdoje trotuari qe ka nisur sepse rrezikohen banoret dhe nxenesit	3. Fatkeqsisht nuk kemi shume pritje, sepse ate pjese qe ka përfunduar e ka realizuar niveli qendror, nga këtu deri ne fshatin Terrnavc
Muhamet Hamza: Poligoni qe eshte ndërtuar ne lagjen Osaj nuk iu lejohet fëmijëve te tjerave lagje te lozin	4.Do ta bisedojmë me ktuetarin dhe ta bëjmë nje zgjidhje, ai poligon eshte publik dhe i te gjithve
Si bëhet publikimi i listave të subvencioneve?	3.Publikimi i listave të subvencioneve bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe udhëzimet e AIP.

Komentet – Janë dhënë gjithsej 6 komente, 4 do të përfshihen në buxhet

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Buxheti komunal	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F 0 M 9 T 9	Klinë e Epërme	6 komente, 4 merren parasysh	Njoftimi » KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 (rks-gov.net) Lajmi » Kanë nisur sot dëgjimet buxhetore për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027. (rks-gov.net) Procesverbali 1891_240918080842_001.pdf (rks-gov.net)

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik


Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura

Procesverbali



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

№:
No. 04-400/01-0045314/24
Data:
Data 17.09.2024



Komuna e Skenderajt
Shtetëria Opštine Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal
i diskutimit publik për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025

Data: 21.08.2024

Ora: 13:30

Vendi: Klinë e Epërme

Të pranishëm: Drejtori i drejtorisë së financave, drejtori i drejtorisë së urbanizimit, 9 persona qytetarë dhe nga Ojq

Përshkrim i përgjithshëm

Ky diskutim publik mbahet konform thirrjes publike nr.02-060/01-00388731/24 i datës 12.08.2024

Ismet Aliu-drejtor i drejtorisë për buxhet dhe financa: Përsëndetje, mirë se keni ardhur në takim të fundit për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025. Ju përcjellë edhe përsëndetjet e kryetarit z.Nura. Konform legjisllacionit dhe qarkoves buxhetore dhe konform vullnetit të kryetarit që buxhetin ta vejmë nëpër vija sipas kërkesave tuaja edhe sipas kufijve fillestar dhe qarkores përfundimtare. Ky buxhet parasheh investime kapitale, shërbime dhe mallra, grante dhe subvencione e secila të ndara në kategori dhe kode buxhetore

Pjesë nga diskutimi i qytetarëve

Selim Bajraktari: Në Klinë të mesme kemi nevojë për asfaltim të disa rrugëve të lagjeve, ndriçim publik dhe një pjesë të ri-rregullohet kanalizimi.

Samir Tahiraj: Kur pritët të fillon subqendra dhe a do të ketë mundësi që nëse don dikush mos të iu rrënohet lokali. Poashtu kemi nevojë edhe për një poligon sportiv.

Ferit Bajraktari: Kerkojmë që trotuarat në rrugën kryesore të rregullohet se po rrezikohen edhe fëmijët si dhe shënjestimet e rrugëve dhe vendkalimeve për këmbësor.

Muhamet Hamza: Poligoni në lagjen Hamzaj nuk po mund të lozin fëmijët sepse banorët aty u thonë është fushë vetëm e kësaj lagjeje

Driton Mulaj: Asfaltimi dhe trajtimi i rrugëve të lagjeve ka filluar dhe do të kryhen kemi kontratë. ndriçimin jemi duke punuar në qytet dhe pastaj kalojmë në Klinë të Ulët, Turiqeve pastaj tek ju. për poligon nuk kemi mundësi me ndërto prapë poligon, kanalizimi do të rregullohet, ndërsa subqendra do të ndërtohet sipas kërkesave tuaja e nevojave tuaja duke mos dëtuuar prona as ndërtime private.


Ismet Aliu: Do të mundohemi që kërkesat tuaja të i inkorporojmë në projekt-buxhet, në skajet tjerë, ju falënderojmë.



Procesmbajtësi Mirsad Gashi



Republika e Kosovës
 Republika Kosova
 Republic of Kosovo





Komuna Skenderaj
 Opština Skenderaj
 Municipality of Skenderaj

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Data: 21.08.2024, ora 13:30

Vendi: Shkolla "Idriz Baran", Klinë e Epërme

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
2	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
3	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
4	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
5	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
6	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
7	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
8	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
9	Arif Ahmeti	Klinë e Epërme	[Signature]
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027

Procesi i hartimit të buxhetit është shumë i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Skenderajt, të cilët nëpërmjet propozimeve dhe kërkesave për investime kapitale për vitin e ardhshëm, bëhen pjesë e vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të mbahen me datat 21 dhe 22 gush, sipas kalendarit të detajuar.

Në këto takime mund të marrin pjesë qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme, grupe të caktuara të interesit, gratë, pensionistët, të rinjtë, klubet sportive, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj.

Nr.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë për hartimin e buxhetit 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027	Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Vendi i mbajtjes	Ora
1.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Klinë e Epërme, në Shkollën "Idriz Berani"	13:30
2.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Rurik, në Shkollën "Shotë Galca"	15:30
3.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Turqec, në Shkollën "Abedin Rexha"	13:30
4.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Salla e Kuvendit Komunal, Kati IV	15:00

Komentet, kërkesat dhe sugjerimet lidhur me procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027, mund t'i dërgoni në emailat: smet.aliu@ark-sgov.net dhe jeton.rushiti@ark-sgov.net



Amir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun